



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIAE PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1016 Prot.

Fier, më 07.12. 2020

SHPALLJE 7/1

**E VENDIT TE LIRE PER DREJTOR TE INSTITUCIONIT PUBLIK TE ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR (IPAP) TE DRAP FIER**

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, në zbatim të Ligjit nr.69/2012 “Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar, VKM nr.99 datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Udhëzimit nr.2 datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar” i ndryshuar me Udhëzim nr.7 datë 19.03.2020 të MASR si dhe bazuar në kërkesën e ZVAP Roskovec me nr.1061 prot. datë 04.12.2020, protokolluar me tonën me nr. 1016 prot. datë 04.12.2020, shpall vendin e lirë të punës për drejtor në institucionin publik të arsimit parauniversitar IPAP si më poshtë:

1. Shkolla e mesme “Adem Vrapi “ , Roskovec;
2. Shkolla 9-vjeçare “ Alush Grepcka ”, Roskovec;
3. Shkolla 9-vjeçare “ Ajet Toska” Suk 2;
4. Shkolla 9 vjeçare “7 Dëshmorët”, Strum ;
5. Shkolla 9- vjeçare “Jorgo Sopiku”, Luar ;
6. Shkolla 9-vjeçare “Zylyftar Veleshnja”, Velmish.

1) Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për drejtor të IPAP:

- a) të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlefshme me të, sipas përcaktimeve të ligjit nr.80/2015 ”Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Rëpublikën e Shqipërisë”,
- b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;
- c) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;
- d) të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55 të ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2) Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

A. Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban :

- a) Jetëshkrimin dhe kopjet e njehsuara me origjinalin të dokumentave që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.1 bashkëlidhur Udhëzimit nr.2 datë 28.01.2020);
- b) kopjen e njësuar me origjinalin të librezes së punës;
- c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);

- d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 4 bashkëlidhur Udhëzimit nr.2 datë 28.01.2020);
 - e) certifikatën e drejtuesit të IPAP.Certifikimi i kandidatit për drejtor i IPAP kryhet pas zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve , për drejtimin e IPAP;
 - f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.2, bashkëlidhur Udhëzimit nr.2 datë 28.01.2020);
 - g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
 - h) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit /bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.3, bashkëlidhur Udhëzimit nr.2 datë 28.01.2020.
- Drejtori aktual i IPAP ose zëvendësuesi i tij vë në dispozicion të secilit aplikant një kopje të dokumentave të mëposhtme:
 - a) planin afatmesëm të shkollës;
 - b) planin vjetor të shkollës të vitit paraardhës;
 - c) raportin vjetor të shkollës të vitit paraardhës.

B. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP Roskovec brenda afatit 07.12.2020- 17.12.2020.

- 3) **Data e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit.**
Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen **në periudhën kohore 18.12.2020-21.12.2020.** Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.
- 4) Pas vlerësimit të dosjeve aplikantët me dokumentacion të plotë dhe të saktë do të kryejnë intervistën e strukturuar për :
- Fushat e njohurive dhe të aftësive në drejtimin e institucionit mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar:**
- a) Ligji nr.69/2012 “Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar ,
 - b) Strategjia kombëtare e zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020;
 - c) Urdhër nr.31 date 19.01.2020 “Per miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”
 - d) Udhëzim nr.13 datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimit dhe të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mesues për Shqipërinë”;
 - e) Udhëzim nr. 30 datë 12.09.2018 ‘Për numrin e nxenesve për klasë dhe normat e punës arsimore”;
 - f) Udhëzim nr.2 datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”
 - g) Udhëzim nr.58 datë 12.11.2013 “ Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik”;
 - h) Ligj nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike “;
 - i) Kodi i Punës i Republikës se Shqipërisë ;
 - j) Kodi i Procedurave Administrative te Republikës se Shqipërisë.

- 5) Rezultatet përfundimtare të konkurimit do të shpallen në këndin e njoftimeve të institucionit arsimor përkatës **në periudhën kohore 28.12.2020-30.12.2020**
- 6) Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda 3 ditë pune nga shpallja e rezultateve të konkurimit.

Në vijim të procedurave të emërimit, referuar Udhëzimit Nr.2 date 28.01.2020 i ndryshuar me Udhëzim nr.7 / 2020 , dokumentacioni i dy kandidatëve me më shumë pikë i percillet Drejtorit të DRAP Fier, nga Drejtori i ZVAP Roskovec në periudhën kohore 08.01.2021-11.01.2021.

DREJTORI



BRUNILDA DHAMO

